



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-30276/22 datë:24.10.2022



Npi – 01/330 datë:27.10.2022

REKOMANDIMET

Nga mbledhja e -VII- e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më: 27.10.2022

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.09.2022

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më: 23.09.2022.

Pika 2

Raport nëntëmujor Buxhetor Janar-Shtator 2022

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” (Me përdorimin e votës së dyfishtë të Kryesuesit sipas nenit 48.1 të LVL Nr.03/L-040), vendosi ti rekomandoj Kuvendit miratimin e Raportit nëntëmujor buxhetor Janar-Shtator 2022. Me vërejtjen që në mbledhjen e Kuvendit të japin sqarime shtesë për raportin drejtorët e : Prokurimit, Urbanizmit, dhe Shërbimeve Publike.

Pika 3

Propozim-Vendim për caktimin e normave tatimore për vitin 2023

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që t’i rekomandoj Kuvendit miratimin e Vendimit për caktimin e normave tatimore për vitin 2023, me propozimin që te pika 7. (Njësitë komerciale të objekteve) nga norma tatimore 0.15% të rritet në normën tatimore në 0.18%.

Pika 4

Draft-Rregullore për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në komunën e Shtimes

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që t’i rekomandoj Kuvendit miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Rregulloren për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në komunën e Shtimes.

Pika 5

Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm Ngastrën Kadastrale Nr.752/0, Z.K – Carralevë

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që t’i rekomandoj Kuvendit miratimin e Vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm Ngastrën Kadastrale Nr.752/0, Z.K – Carralevë.

Pika 6

Propozim – Vendim për formimin e Komisionit për Hartimin e Rregullores së re të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për formimin e Komisionit për Hartimin e Rregullores së re të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, sipas propozim-vendimit të Ekzekutivit Nr.02/649 të datës 24.10.2022.

Pika 7

Draft-Strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Strategjinë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025, me propozimin që në mbledhjen e Kuvendit të na jep sqarime shtesë përfaqësuesi i Zyrës për Informim.



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi